

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Në mes të Universitetit "Haxhi Zeka" dhe Habitat L.L.C.

Preambulë

Ky Memorandum Mirëkuptimi lidhet ndërmjet:

- **Universitetit "Haxhi Zeka"**, me seli në Pejë, Republika e Kosovës (në vijim: "Universiteti"), dhe
- **Habitat L.L.C.**, kompani private e regjistruar në Prishtinë, Kosovë, e specializuar në teknologjitë klimatike dhe komunikimin e gjelbër (në vijim: "Habitat").

Palët, duke njohur rëndësinë e bashkëpunimit akademik dhe teknologjik për qëndrueshmëri mjedisore dhe zhvillim të dijes, bien dakord mbi kushtet dhe parimet e përcaktuara më poshtë.

Neni 1 – Objekti i Marrëveshjes

Habitat L.L.C. i ofron Universitetit "Haxhi Zeka" përdorimin falas të **kalkulatorit të karbonit Karbon360** për periudhën njëvjeçare dhe me mundësi vazhdimi, duke filluar më **Tetor 2025**. Qëllimi i këtij bashkëpunimi është mundësimi i gjenerimit të raporteve të sakta për gjurmën e karbonit, sipas standardeve evropiane **GHG Protocol**, duke ndihmuar universitetin në hulumtim, edukim dhe praktika të gjelbra institucionale.

Neni 2 – Trajnimi dhe Shfrytëzimi i Njohurive

1. Habitat angazhohet të ofrojë **trajnim profesional për dy punonjës të Universitetit**, të cilët do të aftësohen në përdorimin e platformës Karbon360.
2. Punonjësit e trajnuar obligohen që të bartin njohuritë e fituara vetëm brenda institucionit universitar dhe jo jashtë tij, për të mbrojtur integritetin dhe pronësinë intelektuale të teknologjisë.

Neni 3 – Shfrytëzimi i të Dhënave

1. Me shkas të përdorimit falas të mjetit, Universiteti autorizon Habitat që të shfrytëzojë të dhënat e gjeneruara për:
 - hulumtime shkencore,
 - analiza dhe studime akademike,
 - qëllime të marketingut dhe PR-it, përfshirë prezantimet publike të teknologjisë.
2. Logoja dhe emri i Universitetit mund të përdoren nga Habitat në faqet zyrtare të kompanisë, në materialet promocionale dhe në prezantimet e markës, gjithmonë duke respektuar reputacionin e institucionit dhe duke shmangur çdo keqpërdorim.

Neni 4 – Parimet dhe Standardet

1. Palët bien dakord që ky bashkëpunim të zhvillohet mbi bazën e **parimeve të integritetit akademik, transparencës dhe profesionalizmit.**
2. Teknologjia Karbon360 është e **para e llojit të saj në Kosovë**, e zhvilluar mbi faktorë vendor dhe e protokolluar sipas formulave evropiane të **GHG Protocol.**
3. Të dhënat e përdorura do të trajtohen me seriozitet, duke respektuar standardet e mbrojtjes së informacionit dhe konfidencialitetit.

Neni 5 – Kohëzgjatja dhe Fuqia Juridike

1. Ky Memorandum hyn në fuqi më **11 shtator 2025**, në Pejë, Republika e Kosovës, dhe mbetet i vlefshëm për periudhën njëvjeçare nga kjo date.
2. Pas përfundimit të periudhës së përcaktuar, palët mund të negociojnë rinovimin ose zgjerimin e bashkëpunimit përmes një marrëveshjeje të re ose aneksimi të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

Neni 6 – Dispozita të Përgjithshme

1. Ky Memorandum nuk krijon marrëdhënie financiare apo obligime monetare ndërmjet palëve, përtej asaj që është specifikuar shprehimisht.
2. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë zbatimit të këtij Memorandumi Mirëkuptimi do të zgjidhet në mënyrë miqësore; në rast të kundërt, palët mund t'i drejtohen gjykatave kompetente në Kosovë.
3. Memorandumi hartohet në **dy kopje origjinale** në gjuhën shqipe, nga të cilat secila palë mban një kopje.

Për Universitetin "Haxhi Zeka"

Armand Krasniqi
Rektor

Për Habitat L.L.C.

Jeta Berisha
Drejtore Ekzekutive



REKTOATI

Nr. / Br. / No. 2140	Nr. /faq. Br. /tr / No. pg 2
Data / Datum / Data: 11.09.2025 Pejë / Peë	


habitat.